

V E N D I M
Nr.100, datë 27.2.1999

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT KUNDËRPARTI TË BASHKËFINANCIMIT JAPONEZ, ME
PROJEKTIN ASAC**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Nga transhi i dytë i kredisë japoneze për projektin ASAC të përdoren 453 000 000 (katërqind e pesëdhjetë e tre milionë) lekë për rimbursimin e shpenzimeve për investimet e kryera në vitin 1998 nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Ngarkohet Ministria e Financave të kryejë transaksionet e nevojshme në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

1.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko